



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 (pika c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, K145/2020 dhe K146/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 14.09.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj.Arbnore Kelmendi**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik "Nisma Socialdemokrate", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Driton Ademi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Arbnore Kelmendi, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 14.09.2022, nr.1057/2022, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Driton Ademi, me rastin e dorëheqjes së tij, për arsye personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur është znj.Arbnore Kelmendi.

Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.09.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoviq





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 (pika c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 14.09.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.Hafiz Krasniqi**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Fisnik Osmani.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Hafiz Krasniqi, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 13.09.2022, Nr.1053/2022, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Fisnik Osmani, pas dorëheqjes së tij për arsye të angazhimeve tjera profesionale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati në listën e rirenditur është z.Hafiz Krasniqi.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.09.2022

Kryesues i Komisioni Qendror të Zgjedhjeve

